



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.2539 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

V E N D I M

Nr. 90, datë. 21.12.2023

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN NËNTOR 2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 21 të ligjit nr 57/2019 " Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 597 datë 04.09.2019" Për përcaktimin e procedurave , të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike " nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2023". Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave . "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 date 29.12.2021;

Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr 4 datë 31.01.2023 "Për miratimin e kriterëve , procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor" Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës 21.12.2023

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% për muajin **Nëntor 2023**, **16** familje me fond **78429** lekë , bashkëlidhur sipas tabelës .

+	EMER ATËSI MBIEMËR	NR.ANTARËVE NË FAMILJE	SHUMA
	BASHKIA E QYTETIT TEPELENË		
1	MAJLINDA EQEREM BAKO	2	3703
2	BUJAR VESEL METO	1	2178

3	ANULA KANAN MAMA	2	3703
4	JETNOR ZYBER ÇUNAJ	1	2178
5	ELTON BARJAM ÇELA	2	3267
6	MONIKA SAFET BETA	3	7920
7	MARSELA MYZAFER ISUFI	2	3703
8	BRUNILDA MYZAFER KERI	4	10692
9	ALMIRA ÇETI HAZBIA	1	2178
10	ROVENA ASTRIT RACO	4	10692
11	MELISA DULAJ	2	5940
12	BRUNILDA RIZA MAMAJ	2	3703
	SHUMA		59857
	NJESIA ADM. QËNDËR		
1	HEDO GOXHA	3	5227
2	ANDON SHUMELI	3	5227
	SHUMA		10454
	NJESIA ADM. KURVELESH		
1	MARJETA VESHI	1	2178
	NJESIA ADM LOPËS		
1	KLODJANA ZENEL SULAJ	2	5940

	SHUMA		5940
		SHUMA TOTALE	78429

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar, Drejtoria Ligjore (sektori I ndihmës ekonomike), Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 11(njëmbëdhjetë) vota
Vota Pro 11(njëmbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETARI I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2539/1 prot.

Tepelenë, më 22.12.2023

V E N D I M

Nr.91, datë 21.12.2023

PËR DHENIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QE DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN NËNTOR 2023.

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “ neni 21 të ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr 597, datë 04.09.2019, “Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe ërdorimit të fondit shtese mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike” VKB nr .95. datë 25.11.2022 “ Për miratimin e buxhetit për vitin 2023”, VKB nr. 4. Datë. 31.01.2023 “ Për miratimin e kriterëve procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor ” Këshilli i Bashkisë :

V E N D O S I

1. Të trajtojë me ndihmë ekonomike 55 familje me fond 148.000 lekë. Bashkëlidhur tabela.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria ekonomike & menaxhimit financiar Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria Ligjore, Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miraturar me 11(njëmbëdhjetë) vota

Vota Pro 11(njëmbëdhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI



BASHKIA TEPELENE

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE FONDE BASHKISE

NENTOR 2023 F BASHKIS

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firme
1	AGRON CAUSHI	3000			3000		
2	ARTUR ALIAJ	2000			2000		
3	AGRON BEGAJ	3000			3000		
4	SABRI CUNA	2000			2000		
5	MARJOLA GOXHARI	3000			3000		
6	FATMIRA LOCI	3000			3000		
7	SIMJON CUNA	3000			3000		
8	MIKEL MECO	3000			3000		
9	NAFIE MULLARA	2000			2000		
10	MYZAFER LICAJ	3000			3000		
11	GJYLO MERJO	3000			3000		
12	KOSTANOVA BEJKO	2000			2000		
13	KUJTIM HAMZAI	2000			2000		
14	MECO HYSENAGARAJ	3000			3000		
15	RUDIN CUNAJ	3000			3000		
16	PETRIT KARAFILI	2000			2000		
17	VIKTOR SAKA	3000			3000		
18	QENDRIME RACO	2000			2000		
19	SHPETIM MUSARA	3000			3000		
20	GJOLEK AVDULI	2000			2000		
21	JETMIRA HALILI	3000			3000		
22	GAFUR QENDRAJ	3000			3000		
23	ERMAL CUNA	3000			3000		
24	KASTRIOT VARFA	3000			3000		
25	SHPRESA KASA	5000			5000		
26	ERIDA LEPURI	3000			3000		
	SHUMA	72000			72000		

ADMINISTRATORI SHOQEROR

Armand Sala




NJESIA QENDER

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

NENTOR 2023 F BASHKIS

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firme
1	ISMET ZIA	3000			3000		
2	AGIM MUCOPATA	3000			3000		
3	FLAMUR GJYRDEDI	2000			2000		
4	FILE MUCA	2000			2000		
5	ILIR GERBI	3000			3000		
6	ILIR BODECI	3000			3000		
7	BLERTA GJOKTHOMI	2000			2000		
8	TATJANA HOXHA	2000			2000		
9	ARTAN SUNDA	3000			3000		
10	PERPARIM AHMETI	3000			3000		
11	DIAMANTA BALLIA	3000			3000		
12	KRISTINA RRAPI	3000			3000		
13	SADIK VARFI	3000			3000		
14	BUJAR BRAHO	2000			2000		
15	HASKO DURA	2000			2000		
16	NEXHMIJE XHEBRA	2000			2000		
17	HEROINA ZENELI	2000			2000		
18	AHMET BEQIRI	2000			2000		
19	FLORA XHEBRA	2000			2000		
20	VALDET SINORUKA	3000			3000		
21	PELLAGJI KUCA	3000			3000		
22	ADERIANA SALA	2000			2000		
23	JULIANA IMERA	3000			3000		
	SHUMA	58000			58000		

**ADMINISTRATOR SHOQEROR
ROVENA MULLARA**




NJESIA KURVELESH

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

NENTOR 2023 F BASHKIS

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	
1	BANUSH META	3000			3000		
2	DASHO KUCA	3000			3000		
3	ALFRED LENA	3000			3000		
4					0		
5					0		
6					0		
7					0		
8					0		
9					0		
10					0		
11					0		
12					0		
	SHUMA	9000	0	0	9000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR
PAOLA DEMIRI




NJESIA LOPES

LISTE PAGESA E NDIHMES EKONOMIKE

NENTOR 2023 F BASHKIS

Nr	Emri e Mbiemri				SHUMA GJITHSEJ	Nr.kartes ID	firmë
1	MATJOLA ZERAJ	3000			3000		
2	PELLUMB IMERAJ	3000			3000		
3	AXHEM HASANI	3000			3000		
					0		
5					0		
6					0		
7					0		
8					0		
9					0		
10					0		
11					0		
12					0		
13					0		
	SHUMA	9000	0	0	9000		

ADMINISTRATOR SHOQEROR
FESTIME ELEZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 2539/2 prot.

Tepelenë, më 21.12.2023

V E N D I M

Nr. 92, datë 21.12.2023

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a e VKM nr.362, datë 29.05.2019 për “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si dhe Urdhërit Nr 38 datë 17.02.2023 për “Ngritjen e grupit të punës për miratimin e vlerës mesatare sipas strukturës së apartamenteve në treg të lirë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:


1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamentave në territorin e Bashkisë Tepelenë, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar Lekë
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	Muaj	1	7000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	8000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	9000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	11000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Vendimi Këshillit Bashkiak Nr.10, datë 28.02.2022 “Për vendosjen e masës së qirasë vjetore për banesat sociale me qira në Bashkinë Tepelenë” shfuqizohet.
4. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet zyra e strehimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr .139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 14 (katërmëdhjetë) vota
Vota Pro 14 (katërmëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2539/3 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

V E N D I M

Nr. 93, datë. 21.12.2023

“PËR MIRATIMIN E INDIVIDIVEVE/FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” , SIPAS PROJEKTIT TË BASHKISË TEPELENË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, vendimit nr.35, datë 28.04.2022 “Për miratimin dhe zbatimin e programit social të strehimit për subvencionimin të interesave të kredisë, hartuar sipas udhëzuesit operacional”, marrëveshjes mbi kreditimin nga RBAL, të nevojave për strehim të të pa strehëve sipas projektit të Bashkisë nr.2381. datë 06.12.2021, si dhe në vijim të relacionit të Komisionit të Strehimit, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës se individëve/familjeve qe përfitojnë nga programi social “Subvencionimi i interesave te kredisë”,sipas aneksit nr.1 bashkelidhur dhe pjese perberse e këtij vendimi.
2. Individët/familjet e përcaktuara në Aneksin nr.1 të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucionit bankar brenda 6 (gjashtë) muajve nga momenti i njoftimit të këtij vendimi.

3. Pavarsisht parashikimeve të pikës 2, në rastet kur individi/familja nuk gjejnë banese brenda 6(gjashtë) muajve nga momenti i njoftimit, të paraqiten pranë institucionit financiar, si dhe Bashkisë Tepelene, përpara përfundimit të këtij afati duke kërkuar shtyrjen e tij edhe për 6 (gjashtë) muaj të tjerë. Mos respektimi i këtij afati përbën shkak për skualifikimin e tyre.

4. Drejtoria Ligjore pas ezaurimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim të dërgoj pranë institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrveshja, listat përfituese.

5. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Shërbimet Organizative dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miraturar me 14 (katërmëdhjetë) vota
Vota Pro 14 (katërmëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.2539/4 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

V E N D I M

Nr. 94, datë. 21.12.2023

**“PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËS TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DHE ARSIMIT PROFESIONAL NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR
VITIN SHKOLLOR 2023- 2024”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 në zbatim të VKM Nr 666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënës të Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”, VKM Nr 511 datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr 666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënës të Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”, shkresës Nr 19749 prot datë 30.10.2023 “Plani i shpërndarjes së bursave për nxënës që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të Arsimit Profesional për vitin mësimor 2023- 2024 ” dërguar nga Drejtoria e politikave të punësimit dhe aftësimit profesional të Ministrisë së Financave është miratuar plani i bursave për nxënës që ndjekin studimet pranë Institucioneve Arsimore publike të arsimit profesional gjithsej 5 (pesë) për Bashkinë Tepelenë si dhe Shkresës nr 6470/76 prot datë 30.11.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar “Për planin e bursave për nxënës që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar , për vitin shkollor 2023- 2024” për Bashkinë Tepelenë është dërguar plani i bursave 20 (njëzetë).

Këshilli Bashkiak pas shqyrtimit të relacionit të ardhur nga Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social

VENDOSI:

A- Te miratojë dhënien e bursave (bursë e plotë) për nxënës që ndjekin arsimin parauniversitar profesional si më poshtë :

1- Azis Selam Hada

Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë, dega TIK

2- Orest Dritan Tuka

- Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë, dega Termohidraulike
- 3- Fabjan Sokrat Kasneci
Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë, Shërbime mjeteshtari transporti
- 4- Albi Pëllump Imeri
Shkolla e Mesme Industriale "Pavaresia" Vlore.

- 5- Stiljano Llukan Gjokthomi
Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë

B- Të miratojë dhënien e bursave (bursë e plotë) për nxënës që ndjekin arsimin parauniversitar si më poshtë:

- 1- Myrteza Adriatik Mamullari
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, regjistruar në konvikt
- 2- Aleksandra Jetnor Braha
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë
- 3- Natalia Admir Hoxha
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, regjistruar në konvikt
- 4- Mirdita Gazmend Hysenaj
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë
- 5- Matjas Krenar Kaba
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, regjistruar në konvikt
- 6- Ornela Hyso Zia
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë
- 7- Hyqmet Artan Caci
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, regjistruar në konvikt
- 8- Saço Ilirjan Çela
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, regjistruar në konvikt
- 9- Laert Bardhyl Koka
Klasa VII Shkolla 9-vjeçare "Avni Rustemi" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, regjistruar në konvikt
- 10- Zilo Shkelqim Tahiri
Klasa IX Shkolla 9-vjeçare "7 Marsi" Tepelenë, regjistruar në konvikt
- 11- Esmeralda Proletar Kërçani
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, regjistruar në konvikt
- 12- Eriola Rudin Shaha
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, regjistruar në konvikt
- 13- Era Skënder Shaha
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, regjistruar në konvikt
- 14- Kristian Qani Bërxa
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.202,

C- Të miratojë dhënien e bursave (gjysme bursë) për nxënës që ndjekin arsimin parauniversitar si më poshtë:

- 1- Amantia Viktor Kacorri
Klasa e XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, regjistruar në konvikt

- 2- Marsida Veli Kërçani
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelene, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, rregjistruar në konvikt.
- 3- Enkel Përparim Sadikaj
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.202, rregjistruar në konvikt
- 4- Doljan Dashnor Shortaj
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, rregjistruar në konvikt
- 5- Anxhela Shpëtim Kuçi
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, rregjistruar në konvikt
- 6- Hodo Skënder Sulejmani
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, rregjistruar në konvikt
- 7- Denisa Shaban Buqa
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë
- 8- Klodjana Aranit Hasani
Klasa X Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, rregjistruar në konvikt
- 9- Antonio Sofokli Toti
Klasa XII Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023, rregjistruar në konvikt
- 10- Olti Shkelqim Haxha
Klasa Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, rregjistruar në konvikt
- 11- Hajder Aleksandër Çela
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë, përfitues i bursës sipas VKB nr 104 datë 23.12.2023,
- 12- Arsiola Gramos Divintari
Klasa XI Gjinnazi "Abaz Shehu" Tepelenë.

C. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

D.Për zbatimin e këtij vendimin ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miruar me 14 (katërmëdhjetë) vota
Vota Pro 14 (katërmëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 2539/5 prot.

Tepelenë, më 21.12.2023

V E N D I M

Nr. 95, datë 21.12.2023

PËR DHËNIE TITULL NDERI

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 21/12/2023, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 pika “m”; Ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH” pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë,

V E N D O S I:

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. **Sali Sabri Dervishi (pas vdekjes)** me motivacionin:” *Për përkushtim maksimal në mbrojtje të atdheut në Luftën e Çetës së Pezës dhe kontributin gjatë Luftës Antifashiste Nacional – Çlirimtare. Patriot I përkushtuar në shërbim të popullit dhe Atdheut”.*
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. **Ferdin Remzi Liçaj (pas vdekjes)** me motivacionin:” *Për veprimtari të shquar intelektuale, shkencore e sociale në fushën e pylltarisë, kullotave, mjedisit e bimëve medicinal dhe si veprimtar shoqëror, patriotike e intelektual në ndihmë të komunitetit të Tepelenës”*
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. **Gole Llambi Prifti (pas vdekjes)** me motivacionin:” *Për përkushtim maksimal në mbrojtje të atdheut gjatë Luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare. Patriot I përkushtuar në shërbim të popullit dhe Atdheut”.*

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratur me 14 (katërmëdhjetë) vota

Vota Pro 14 (katërmëdhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2539/6 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

V E N D I M

Nr. 96, datë. 21.12.2023

**PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH,
BASHKIA TEPELENË**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 21.12.2023 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 23, të nenit 54 shkronja “ll”, dhe nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, relacionit të Drejtorisë së Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social

V E N D O S I

- 1- Miratimin e emërimit me emrin “Xhemil Çela” (Pas vdekjes) të rrugës sipas fragmentimit të hartës bashkëngjitur, në njësinë Administrative Kurvelesh Tepelenë si më poshtë:

Segmenti: nga Pika 1 me Koordinata $E=491407.36, N=4453072$ në Pikën 2, $E=490373.04, N=4454615.10$ Segmenti (Degëzimi i rrugës së Kucit deri në dalje të fshatit Gusmar)

- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social si dhe Njësia Administrative Kurvelesh Tepelenë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore dhe konfirmimit ligjor nga institucioni I Prefekti të Qarkut Gjirokastër.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 14 (katërmëdhjetë) vota
Vota Pro 14 (katërmëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETARI I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIATEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2539/7 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

VENDIM

Nr. 97, datë 21.12.2023

“PËR MIRATIMIN PLANIT OPERACIONAL PËR VITIN 2024 NE FONDIN PYJOR DHE KULLOSOR TË BASHKISË TEPELENË”

Në mbështetje të, pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe gërmes "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit nr.57/2020 "Për pyjet" VKM 438 datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit pyjor dhe të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore" si dhe në mbështetje të VKM 559 datë 29.07.2022" Për përcaktimin e tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe prodhimet drusore jo pyjore" Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive".

VENDOSI:

1. Të miratojë, propozimin e Drejtorisë së Zhvillimit Rural për përgatitjen e Planit operacional vjetor për vitin 2024.
2. Të ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe Sektori i Sherbimit pyjor pranë Drejtorisë së Zhvillimit Rural për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6 te nenit 55 te ligjit nr. 139/2015” Për "vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13 (trembëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETARI I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIATEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2539/8 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

V E N D I M

Nr. 98, datë 21.12.2023

“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT PJESOR TË DISA PARCELAVE PYJORE DHE KULLOSORE, PRONË E BASHKISË TEPELENË”

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e datës 21.12.2023 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tepelenë, për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullosore, pronë e Bashkisë Tepelenë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” e ndryshuar, neni 27 pika 5 dhe neni 54; ligjin 57/2020 “Për pyjet” neni 11 pika 2b; dhe ligjin nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, e ndryshuar; në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- Komunave/Bashkive”, të ndryshuar; Urdhri Nr. 124 datë 04.12.2020 të kryetarit të Bashkisë Tepelenë “Për ngritjen e Komisionit për vlerësimin, verifikimin dhe hartim të planeve të mbarështimit pjesor për pasuritë e paluajtshme të llojit pyje dhe kullota”;

V E N D O S I:

1. Të pranojë kërkesën e Bashkisë Tepelenë “ Për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullosore, pronë e Bashkisë Tepelenë ”
2. Të miratojë dokumentin “Plan mbarështimi pjesor për pyjet dhe kullotat pronë e Bashkisë Tepelenë”, për mbarështimin e 1 (një) ngastër kullosore të ekonomisë kullosore Dukaj-Luzat, dhe 7 (shtatë) nënngastra pyjore të ekonomisë pyjore Kurvelesh; i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë Bashkisë Tepelenë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6 te nenit 55 te ligjit nr. 139/2015” Për “vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota

Vota Pro 12 (dymbëdhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIATEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.2539/9 prot.

Tepelenë, më 22.12. 2023

VENDIM

Nr. 99, datë 21.12.2023

**“PËR SHPREHJEN E PËLQIMIT NË PARIM PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT
KULLOSOR NDODHUR NË BASHKINË TEPELENË ME QELLIM PËR NDËRTIM
AEROGJENERATORË (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.).”**

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; ligjit 115/2014 “Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.9743 date 22.02.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit”; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullisor publik”; shprehjes se interesit te subjekteve “E U GREEN ENERGY” Shpk dhe “winpharma” shpk me nipt përkatësisht L82323006L dhe L21508008T nr.134 datë __.08.2023 protokolluar prane Bashkise Tepelenë me nr.1598 datë 07.08.2023; mbështetur në të dhënat e inventarit të Bashkise Tepelene rezultojnë që sipërfaqja bënë pjesë në inventarin e Bashkise Tepelene përkatësisht të njësive administrative Kurvelesh dhe Qendër;

VENDOSI:

1. Të jap pëlqimin në parim për dhënie me qira për pasuritë si më poshtë, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë subjekteve “E U GREEN ENERGY” Shpk dhe “winpharma” shpk me nipt përkatësisht L82323006L dhe L21508008T :
 - Ngastrat në Ekonominë Kullosore Kurvelesh me numrat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 24, 25, lloji i pasurisë “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelenë me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.

- Ngastrat në Ekonominë Kullosore Dukaj-Luzat me numrat 6, 21, 22, 23, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, lloji i pasurisë ``Kullotë`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelenë me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.
- Ngastrat/nënngastrat në Ekonominë Pyjore Dukaj-Luzat me numrat 9b, 10c, 11b, 21a+b, 32b, 108c, 110a, 112 a+b, 116, lloji i pasurisë ``Pyll dhe kullotë`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelenë me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.

- Të dhënat sipas tabelës së mëposhmtë:

1. Sipërfaqet për vendosjen e kullave, kantier primar dhe nënstacionet.

Nr	Njësia administrative/fshati	Ekonomia Kullosore/Pyjore	Grup ngastrat	Pronari	Sipërfaqe m ²
1	Kurvelesh/Lekdush/Progonat/Gusmar	EK Kurvelesh	1-20, 22-25	Bashkia Tepelenë	44'500
--	SHUMA			--	44'500

Nr	Njësia administrative/fshati	Ekonomia Kullosore/Pyjore	Grup ngastrat	Pronari	Sipërfaqe m ²
1	Qendër/Turan/Dukaj/ Salari	EK Dukaj-Luzat	6, 21-23, 27-37	Bashkia Tepelenë	27'700
	Qendër/ Luzat/ Turan	EP Dukaj-Luzat	9b, 10c, 11b, 21a+b, 32b, 108c, 110a, 112b, 116	Bashkia Tepelenë	4'800
--	SHUMA			--	32'500

2. Sipërfaqja për rrjetin kabllor nëntokësor.

Nr	Njësia administrative/fshati	Ekonomia Kullosore/Pyjore	Grup ngastrat	Pronari	Sipërfaqe m ²
1	Kurvelesh/Lekdush/Progonat/Gusmar	EK Kurvelesh	Sipas gjurmës së projektit.	Bashkia Tepelenë	10'000
	Qendër/Turan/Dukaj/Salari	EK Dukaj-Luzat			
		EP Dukaj-Luzat			
--	SHUMA			--	10'000

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 të Ministrit të Mjedisit "Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te

fondit pyjor dhe kullosor publik” si dhe në perputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit kullosor/pyjor.

3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik”, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Pyjeve e Kullotave publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13 (trembëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur më datë 22.12.2023.

KRYETARI I KESHILLIT

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK
TEPELENË

Nr.8 prot.

Tepelenë, më 21.12.2023

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më datë 21.12.2023. ora 10.00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Tepelenë thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", I ndryshuar, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 30.11.2023.
3. **Projektvendim** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Nëntor 2023".
4. **Projektvendim** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Nëntor 2023"
5. **Projektvendim** "Për miratimin e individëve/familjeve që përfitojnë nga programi "Subvencionimi i interesave të Kredisë, sipas projektit të Bashkisë Tepelenë"
6. **Projektvendim** "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qiras dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë"
7. **Projektvendim** "Për miratimin e bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2023- 2024"
8. **Projektvendim** "Për dhënie tituj nderi"
9. **Projektvendim** "Për emërtim rruge në Njësinë Administrative Kurvelesh Bashkia Tepelenë"

10. Projektvendim “Për miratimin e planit operacional vjetor për vitin 2024 në fondin pyjor dhe kullor të Bashkisë Tepelenë”

11. Projektvendim “Për miratimin paraprak të planeve të mbarështrimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullorë, pronë e Bashkisë Tepelenë”

12. Projektvendim “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë sipas kërkesës së subjekteve të interesuar”

13. Çështje të tjera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes 10.11

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Arben Gumeni
- Latif Kaçaj
- Dino Selimi
- Mirela Varfi
- Miftar Meta ora 10.30
- Marsela Balili ora 10.30
- Matilda Çela
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani
- Ilir Haska
- Besnik Mece
- Marios Jorgo
- Vladimir Gjonca

- Ditar Hodaj ora 10.30

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë

- Muin Muca
- Gezim Shehu
- Arta Shaha

Kryetari I Këshillit Z.Arben Gumeni deklaroi hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës ku drejton pyetje nëse jeni dakort me rendin e ditës

Këshilltarët shprehin dakortësinë me rendin e ditës.

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet rendi i ditës me 11 vota pro.

Pika e dytë e rendit të ditës:“Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 30.11.2023”.

Arben: Kush është dakort me protokollin e mbledhjes së kaluar?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet protokollin me 11 vota pro.

Pika e tretë e rendit të ditës: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Nëntor 2023”.

Arben Gumeni : Jeni njohur me materialin.

Znj.Matilda Çela Kryetare Komisionit të Ekonomise: Dje u mbledh komisioni, diskutuam me përfaqesues të Bashkisë zyra përkatëse, dhe vendosëm të miratohet ndihma ekonomike me fond 6 %, si dhe për pikën tjetër, fondi i Bashkisë për familjet në nevojë për muajin Nëntor të miratohet

Arben: Ti hedhim në votim këto dy pika të rendit të ditës.

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Nëntor 2023", me 11 vota pro.

Miratohet: Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Nëntor 2023", me 11 vota pro.

Pika e pestë e rendit të ditës: "Për miratimin e individëve/familjeve që përfitojnë nga programi "Subvencionimi i interesave të Kredisë, sipas projektit të Bashkisë Tepelenë"

Arben Gumeni : Jeni njohur me materialin.

Znj. Matilda Çela Kryetare e Komisionit të Ekonomisë: Dje në komision diskutuam dhe vendosëm: janë 13 familje që shprehin interesin, ne kemi 15 vende, ato 2 vende do të shohim gjatë vitit 2024 po të shprehin familje të tjera interes ne jemi në ndihmë të tyre. Ti miratojmë familjet që kanë shprehur interes.

Arben : Ta hedhim në votim, ka pyetje

Ditar Hodaj: Si është subvencionimi, cfarë mbulon Bashkia

Arben: Një pjesë mbulon Bashkia

Ditar: Si janë përzgjedhur?

Arben: Janë 15 vende, të gjithë që kanë shprehur interes janë pa banesë.

Matilda: Janë shqyrtuar kërkesat kanë kaluar në komisionin e Bashkisë.

Miratohet: "Për miratimin e individëve/familjeve që përfitojnë nga programi "Subvencionimi i interesave të Kredisë, sipas projektit të Bashkisë Tepelenë" 14 vota pro.

Pika e gjashtë e rendit të ditës: "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qiras dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë"

Arben: Ky projektvendim është për ato familje që marín subvencionim për qira shtëpie. Familjet që marín shtëpi me qira, të cilat janë në gjëndje të vështirë ekonomike i ndihmon Bashkia duke u subvencionuar qiranë.

Matilda: Këtë projektvendim e diskutuam në komision, këtë vit vlera e qirasë është rritur për banesat sipas p/vendimit të paraqitur. Në krahasim me vitin e kaluar është rritur vlera propozoj ta miratojmë, ky p/v në ndihmë të komunitetit.

Arben: Ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qiras dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë" 14 vota pro.

Pika e shtatë e rendit të ditës: "Për miratimin e bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2023- 2024"

Z.Mirela Varfi Kryetare e Komisionit Arsim Kulturës: Ne e diskutam në komision këtë p/vendim të paraqitur nga Drejtoria e Arsim Kulturës. Në bazë të kriterëve, këto familje janë me ndihmë ekonomike, familje në vështirësi ekonomike.

Me pesë bursa janë trajtuar nxënës që ndjekin arsimin parauniversitar profesionale, në Gjirokastrë, Vlorë.

Pjesa tjetër 15 nxënës që ndjekin arsimin parauniversitar janë trajtuar me bursë të plotë, pasi plotësojnë kriteret, pjesa tjetër është trajtuar me gjysëm burse.

Matilda: Konvikti ka 15 shtretër, të tjerë janë plotësuar me gjysëm burse për pagesën e transportit.

Arben: Ka pyetje? Ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: "Për miratimin e bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2023- 2024" 14 vota pro.

Pika e tetë e rendit të ditës: "Për dhënie tituj nderi"

Mirela: Në komision u diskutua ky p/vendim i paraqitur nga Administrata e Bashkisë nga Drejtoria Arsim Kulturës. Për vlerësimin e këtyre figurave për titullin qytetar nderi është një komision i Bashkisë që i vlereson këto figura si më poshtë:

Sali Sabri Dervishi (pas vdekjes), Ferdin Remzi Licaj (pas vdekjes), Gole Llambi Prifti (pas vdekjes)

Arben: Ka pyetje, ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: "Për dhënie tituj nderi" 14 vota pro.

Arben : Pika tjetër "Për emërtim rruge në Njësinë Administrative Kurvelesh Bashkia Tepelenë"

Arta: Ky propozim për emërtim rruge ka ardhur nga Shoqata e Historianëve dhe Ushtarakëve Shqiptar. Kërkojm nga ju miratimin me emrin Xhemil Cela (pas vdekjes) të rrugës sipas fragmentit të hartës bashkelidhur, në njësinë Administrative Kurvelesh.

Ditar: Tek miratimi i rrugës thotë sipas hartës, këtu ka kordinata

Arta: Tani rrugët shënohen me kordinata.

Arben: Ka pyetje, ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: Për emërtim rruge në Njësinë Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelenë” 14 vota pro.

Arben: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës: “Për miratimin e planit operacional vjetor për vitin 2024 në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Tepelenë”

Gezim Shehu Drejtor Zhvillimit Rural: Plani operacional është dokumenti i parë i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga fondi pyjor kullësor. Ky dokument miratohet cdo vit, ne bëjmë planifikimin sa të ardhura do grumbullojmë nga dhënia me qira.

Arben: Ka pyetje, ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: “Për miratimin e planit operacional vjetor për vitin 2024 në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Tepelenë” me 13 vota pro (Keshilltari Z.Dino Selimi për arsye objektive largohet nga mbledhja)

Arben: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës: **“Për miratimin paraprak të planeve të mbarështrimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullësore, pronë e Bashkisë Tepelenë”**

Gezim: Plani i mbarështrimit behët për mbarështrimin ose menaxhimin e parcelave pyjore ose kullësore për 10 vjet, është afati maksimal. Ky plan parashikon masat që do meren ndërhyrjet që do të bëhen, për përmirësimet degradimet për rehabilitimin, investimet e ndryshme që mund të bëhen në varësi të kërkesave të subjekteve për marrje me qira. Plani për tre parcela, dy në Njësinë Adm Kurvelesh fshati Lekdush, dhe një kullësore në Njësinë Adm Qëndër fshati Dukaj.

Ditar: Cfarë do të bëhet tek këto parcela, do shiten do blihen?

Gezim: Plani i menaxhimit bëhet cdo 10 vjet, dhe planifikohen në të ardhmen si do menaxhohen, mund të shiten, mund të mos shiten, mund të jepen për kullotë, me qira ose mund të mos jepen kur nuk ka kërkesa.

Ditar: Ka kërkesa për aktivitet?

Gezim: Po ka kërkesa, jo për të gjitha parcelat, dy kërkesa për Njësinë Adm Kurvelesh, për kullotje, një parcelë kullësore fshati Dukaj për kullotje.

Ditar: Cfarë kërkesë duhet të bëj për të marrë kullotë?

Gezim: Kërkesa bëhet nga cdo subjekt, për qëllime të ndryshme ne bazë të ligjit, duke filluar kullotë, turizëm, ndërtime të ndryshme që lejohen sipas ligjit.

Mirela: Këto kullota do ti jepen fshatit ti përdor me qira apo kullotë?

Gezim: Kush shpreh interes për zhvillim, apo në përdorim për kullotë fshati ose subjekte të tjera. Kjo në Dukaj është për kullotë për 10 vjet, e ka në përdorim ai që aktualisht nuk e paguan në Bashki. Do bëhen procedurat ta marre me qira të paguaj, afati maksimal 10 vjet.

Latif: Tokat me qira mos te vinë në Këshill pa dëgjesa publike

Arben: Ka pyetje, ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? 1 Ditar Hodaj

Miratohet : Për miratimin paraprak të planeve të mbarështrimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullimore, pronë e Bashkisë Tepelenë” 12 vota pro

Arben : Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës: **“Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë sipas kërkesës së subjekteve të interesuar”**

Gezim; Paraqet materialin bashkelidhur.

Ditar: Për energjinë e erës ku do bëhet ky projekt.

Gezim: E kemi kaluar vjet për studim në këshill, janë bërë matjet, tani kërkohet dakortësi të vazhdoj procedura që Bashkia të jetë dakort që zona të ketë zhvillim për energjinë e rinovueshme të erës, pastaj subjektet aplikojnë për të marrë autorizim dhe leje për të vazhduar .

Ditar: Ku janë këto zona?

Gezim: Zonat janë pyje dhe kullotë, duke filluar nga fshati Lekdush deri ne fshatin Gusmar, pjesa e malit kullotë verore, dhe në fshatrat Salari, Dukaj, Turan, dhe një pjesë në fshatin Luzat qe janë parcela pyjore.

Arben: Ka pyetje?

Ditar: Të shikohet ana ligjore, procedurale

Arben: Ka pyetje, ta hedhim në votim

Kush është dakort?

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet: "Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor ndodhur në Bashkinë Tepelenë sipas kërkesës së subjekteve të interesuar" 13 vota pro
Çështje të tjera.

Arben: Kemi kërkuar informacin nga aparati i Bashkisë në lidhje me kërkesat, ankesat e qytetarëve. Po lexoj kthim përgjigje nga administratori i njësise Qytet Z.Florenc Korca Ankesa e Z.Qemal Xhafa pasi u trajtua nga grupi i punës i është lënë detyrë Z. Isa Hasa që ta zëvendësoj dhe të izoloj tubin e shkarkimit, si dhe Z. Qemal Xhafa të heqë strehën e llamarinës së ballkonit si burim lagështire. Pas kësaj kemi shkuar 2-3 herë në shtëpinë e z.Isa Hasa nuk e kemi gjetur në banesë.

Peticioni për parkimet: Grupi i punës është duke punuar për zgjidhjen e ankesës dhe do përgatisë materialin për miratim në Këshill.

Për zënien e hapsirave publike është duke punuar për identifikimin e hapsirave të zëna në qytet, e cila kërkon kohë dhe pas identifikimit në terren do të bëhet identifikimi për pronësinë në ASHK dhe pas verifikimit do të përcillet materiali i përgatitur në këshill.

Matilda: Për gardhet të jënë të sistemuara deri në fund të vitit.

Vladimir Bakiq: Ne në këshill kemi thënë të bëhet pezullimi i gjobave nga policia, gjobat vazhdojnë. Këshilli i kërkon Bashkisë të hiqen tabelat të lejohet parkimi. Eshte shkelur ligji pse janë vënë tabela kur nuk ka vendim. Ti dergohet shkresë policise te mos vihen gjoba qytetarëve.

Arben: Ne si keshill nuk kemi marre vendim për parkimet, peticioni e qytetarëve i është përcjelle Bashkisë.

Ditar: Të bëjme propozim, nuk ka vend ku të parkojmë, venia e tabelave e jashteligjshme, ta hedhim në votim të hiqen tabelat.

Arben: Ne nuk marim vendim jashtë ligjit.

Ditar: Ne e kemi të drejten të marrim vendim për heqjen e tabelave për vend- parkim, deri në zgjidhjen e kesaj suate të krijuar.

Arben: Këshilli propozon për mosndalim të parkimit , dhe heqjen e tabelave në rrugën Ali Pasha'' Hidhet ne votim miratohet 13 vota pro propozimi i Arbenit, kundër ska, abstenim ska.

Kërkesë nga Banori i Njesisë Kurvelesh Z. Bejo Bresha (bashkëlidhur kërkesa)

Arben: Këtë kërkesë t ja drejtojme aparatit të Bashkisë për shqyrtim, pastaj të vi në këshill, për miratim

Ka ardhur shkresë nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë në lidhje me ankesën e Z. Fatmir Cela, për procedurën e zgjedhje se kryetarit të fshatit Turan për tu shqyrtuar në Këshill.

Kjo ankesë është diskutuar në komisionin përkates është votuar dhe miratuar.

Do ta shqyrtojme ankesën drejtuar Prefektit në mbledhjen radhës me komisionin përkates dhe pastaj do kaloj në këshill.

Jeni dakort? po

Matilda Të shikohet procedura.

Latif : Të bëhen zgjedhje.

Arben: Ka pyetje? Jo

Mbyllet mbledhja e Këshillit

SEKTERARE KËSHILLIT
VALBONA ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT
ARBEN GUMENI



Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al

E-mail: info@tepelena.gov.al